U D H Ë Z I M
Nr. 2, datë 26.9.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 22.8.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VLERËSIMIN E APARTAMENTEVE QË NDËRTOHEN ME FONDE SHTETËRORE", NDRYSHUAR ME UDHËZIMET NR. 1, DATË 12.1.2001 DHE NR. 6, DATË 19.7.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

Në udhëzimin nr. 4, datë 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, në paragrafin e parë shkronja "d" të pikës 9, pas fjalëve "Për ushtarakët dhe punonjësit e Ministrisë së Rendit Publik…" shtohen dhe fjalët "të Shërbimit Informativ Shtetëror…" dhe "…Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Rendit Publik…" shtohet dhe Shërbimit Informativ Shtetëror…".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano